



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KABINETI

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërisë Cargeas Assicurazione S.p.A. nga shoqëria Intesa Sanpaolo Vita S.p.A.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.116 prot., i AK, datë 02.03.2021 “Njoftim përqendrimi i garantuar”, ku përfaqësuesi ligjor Loloçi & Associates ka njoftuar mbi transaksionin e përfimit të kontrollit të shoqërisë Cargeas Assicurazioni S.p.A. nga shoqëria Intesa Sanpaolo Vita S.p.A.

Më datë 20 Shkurt 2021 palët kanë nënshkruar “Marrëveshjen e blerjes së aksioneve” nga dhe ndërmjet BNP Paribas Cardif S.A. dhe Intesa Sanpaolo Vita S.p.A.

Palët pjesëmarrëse:

Pala blerëse: Intesa Sanpaolo Vita S.p.A është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionin italian, me objekt veprimtarie: ushtrimin e veprimtarisë së sigurimeve dhe risigurimeve në fushën e jetës, aksidenteve dhe degët e sigurimeve shëndetësore. Intesa Sanpaolo Vita S.p.A kontrollon nga Grupi Intesa Sanpaolo. Grupi Intesa Sanpaolo është i pranishëm në Shqipëri përmes filialit të zotëruar tërësisht prej tij Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA.

Pala shitëse: BNP Paribas Cardif S.A., është një shoqëri franceze, e cila zotëron 100% shoqërinë Cargeas Assicurazioni S.p.A.

Shoqëria Target: Cargeas Assicurazioni S.p.A., është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit italian. Cargeas është aktive në tregun e sigurimit të jo-jetës në Itali.

Cargeas Assicurazioni S.p.A nuk është aktive dhe nuk realizon të ardhur në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.